



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Nr. 01/284/2017
Datë: 01/12/2017

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë, në bazë të nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenit 11 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në takimin e shtatë të përbërjes së parë, të mbajtur më 01 dhjetor 2017 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja Nr. 07/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 03/2017 për Trajnimin Fillestar.
2. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.



Aleksandër Lumezi

A. Lumezi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë
Udhëheqësit të PTF-së
Arkivit të Akademisë së Drejtësisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë /Akademija Pravde /Academy of Justice

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në pajtim me nenin 10, paragrafit 1, nën paragrafi 1.1, dhe nenit 19 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, në mbledhjen e mbajtur me datë 01.12.2017,

Miraton:

RREGULLORE NR. 07/2017

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.03/2017 PËR
TRAJNIMIN FILLESTAR**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Nr.03/2017 për Trajnimin Fillestar (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Neni 2

Neni 6 paragrafi 4 i Rregullores bazë, ndryshohet si në vijim:

4. Gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit trajnimin praktik e ndjekin nën mentorimin e gjyqtarit apo prokurorit të shtetit që punon në Departamentin e Përgjithshëm. Në rast të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve apo prokurorëve të shtetit në Departamentin e Përgjithshëm, mentorë mund të caktohen edhe gjyqtarët apo prokurorët e shtetit të Departamentit të Krimeve të Rënda. Nëse gjyqtarët e sapoemëruar caktohen në Departamentin e Çështjeve Administrative ose Departamentin e Çështjeve Ekonomike të Gjykatës Themelore, mentor mund të caktohen edhe gjyqtarët që punojnë në këto departamente.

Neni 3

Pas nenit 15 të Rregullores bazë, shtohet nen i ri 15/A si në vijim:

Neni 15/A

Struktura e testit

1. Testi me shkrim përmban dy (2) pjesë.
2. Pjesa e parë e testit përbëhet nga pyetje me përgjigje alternative, përmbajtja e të cilave është në përputhje me neni 15 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores bazë.
3. Pjesa e dytë e testit përmban një rast praktik i cili përzgjidhet nga nën modulet të cilat kanë më shumë se 5 sesione trajnimi duke përjashtuar modulin “Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese” ku testi për këtë modul përmban vetëm pyetje me përgjigje alternative.

Neni 4

Neni 17 i Rregullores bazë, pas paragrafit 8 shtohet paragrafi ri 9 si në vijim:

9. Pjesa e testit, pyetje me përgjigje alternative zgjatë 45 minuta, ndërsa pjesa e rastit praktik zgjatë 120 minuta.

Neni 5

Neni 19 i Rregullores bazë, pas paragrafit 4, i shtohet paragrafi i ri 5, si në vijim:

5. Shpallja e rezultateve përfundimtare, bëhet përmes publikimit të listave në tabelën e shpalljeve në Akademi, faqen zyrtare të internetit të Akademisë dhe postës elektronike.

Neni 6

Neni 20 i Rregullores bazë i shtohen paragrafët 3, 4, 5, dhe 6 si në vijim:

3. “Ankesat e pjesëmarrësve në testim, shqyrtohen nga Komisioni i ankesave, në afat jo më gjatë se 10 ditë nga dita e përfundimit të afatit për parashtrim të ankesës.
4. Në rast se Komisioni i ankesave gjen se janë bërë shkelje të rregullave rreth organizimit apo vlerësimit të testit, mund të:
 - 4.1 korrigjoj gabimet teknike dhe të ndryshoj rezultatin e testit;
 - 4.2 kërkoj rivlerësim të testit bazuar në rekomandimet e këtij Komisioni;
 - 4.3 kërkoj përsëritjen e testit për pjesë të caktuar apo për të gjithë testin;
5. Në rast të përsëritjes së testit, ai organizohet brenda 5 ditëve nga vendimi i Këshillit Drejtues. Në këtë rast testi që do t’i nënshtrohet parashtruesi i ankesës, duhet të hartohet përsëri.
6. Lidhur me pikat 4.2 dhe 4.3 Komisioni i bënë rekomandim Këshillit Drejtues për vendosje.”

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Prishtinë, 01.12.2017



Aleksandër Lumezi

A. Lumezi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë